



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 10 nëntor 2025

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 85/100

Përgjithësisht pozitiv



A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”

Ministria udhëheqëse	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Numri/data e RIAs	2025 – MEI – Nr.7
Statusi	Në proces vlerësimi
Data e marrjes për shqyrtim	11 gusht 2025
Data e komenteve të fundit	7 nëntor 2025
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	39/43
Numri i ripunimeve	4

A) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është transpozimi i avancuar i kërkesave të acquis-it të Bashkimit Evropian në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të drejtës së shoqërive tregtare, në veçanti atyre që lidhen me përdorimin e mjeteve digjitale dhe ndërlidhjen e regjistrave.

B) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsytet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është

përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar

C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë *plotësisht* në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të thellohet më tej analiza ekonomike sasiore ekonomike (kosto/përfitimi), për të gjitha grupet e prekura.
2. Të përmirësohen objektivat tsipas modelit SMART, duke u bërë më specifike, të matshëm dhe të lidhur me tregues konkretë të rezultatit (p.sh. ulja e kohës së regjistrimit, rritja e transparencës apo reduktimi i kostove administrative). Kjo do të mundësojë një vlerësim më të saktë të ndikimeve dhe të arritjes së synimeve të reformës.
3. Të shtohen masa të qarta për zbatimin e ndryshimeve ligjore dhe institucionale, duke përfshirë përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, afatet e zbatimit, burimet financiare e njerëzore të nevojshme, si dhe mekanizmat e monitorimit dhe raportimit të progresit. Këto masa do të sigurojnë zbatueshmëri reale të objektivave dhe ndjekje efektive të procesit të reformës.
4. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.